



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRI

Nr. 6758 Prot.

Tiranë, më 05.12 2014

URDHËR

Nr. 534 datë 04.12.2014

PËR

"MIRATIMIN E STATUTIT TË QENDRAVE SHËNDETËSORE".

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 05.11.2014, "Për Financimin e Shërbimeve Shëndetësore Publike të Kujdesit Shëndetësor Parësor nga Skema e Detyrueshme e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor".

URDHËROJ:

Miratimin e Statutit të Qendrave Shëndetësore, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



STATUTI I QENDRËS SHËNDETËSORE

Neni 1

1. Qendra Shëndetësore, që më poshtë do të quhet QSH, është institucioni i shërbimit shëndetësor parësor me financim publik, jo fitimprurës, me llogari bankare më vete, që përfshin të gjithë rrjetin e dhënësve të shërbimit nën varësinë e saj dhe që ushtron veprimtarinë në bazë të Ligjit nr.10107, datë 30.03.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr.10138, datë 11.05.2009 "Për Shëndetin Publik" i ndryshuar, Ligjit nr.10383, datë 24.02.2011 "Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Q.SH. zbaton legjislacionin shqiptar dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë, autoritetet shëndetësore vendore të autorizuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe FSDKSH.

Neni 2

Veprimtaria Q.SH.

1. Q.Sh. ofron shërbime të kujdesit shëndetësor parësor sipas paketës bazë të shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor.
2. Q.Sh. ofron edhe shërbime të specializuara ambulatorore.
3. Q.SH. ushtron veprimtarinë duke zbatuar sistemin e referimit të pacientit të miratuar nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë .
4. Q.Sh. kontrahetohet nga FSDKSH për financimin e shërbimeve shëndetësore që ofron.

Neni 3

Identifikimi i Q.SH.

1. Q.SH. identifikohet përmes të dhënave të mëposhtme :
2. Q.SH. ka qendrën e saj në _____
3. Emërtimi i Q.SH. është Qendra Shëndetësore _____
4. Adresa e Q.SH. është _____
5. Q.SH. mund të ndryshojë emrin dhe selinë vetëm me miratimin e Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

Neni 4

Drejtimi

1. Autoriteti drejtues i Q.Sh. është Drejtori i cili emërohet dhe lirohet nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë. Procedura e emërimit së drejtorit të Q.Sh. bëhet me konkurs të hapur, bazuar në kriteret e përcaktuara nga aktet nënligjore dhe zhvillohet në Ministrinë e Shëndetësisë.

Drejtori i Q.Sh. ka këto përgjegjësi:

- a. Organizon dhe drejton punën e Q.SH.
- b. Zbaton rregulloren e miratuar nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë, të organizimit dhe funksionimit të Q.SH.
- c. Autorizohet nga Ministri përgjegjës për shëndetësisë të lidhë kontratën individuale të punës me secilin nga punonjësit e Q.Sh.
- d. Çel llogarinë bankare të Q.SH. pranë një banke të nivelit të dytë, e cila ka degë në afërsi të Q.Sh.
- e. Paraqet në DRFSDKSH dhe në DRSH/DSHP/ASHR përkatëse, projekt-buxhetin dhe bilancin përkatës të QSH.
- f. Është përgjegjës për zbatimin e buxhetit sipas rregullave që përshkruhen në kontratë.
- g. Respekton rregullat përkatëse në fuqi për mbledhjen e të ardhurave nga tarifatat për shërbime ndaj të pasiguarve, apo shërbime të ofruara jashtë paketës së kontraktuar.
- h. Është përgjegjës për cilësinë e shërbimeve të ofruara.
- i. Miraton përshkrimin e punës për çdo punonjës në Q.SH.
- j. Raporton pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe ISHP, të dhënat e kërkuara në zbatim të Sistemit të Informacionit Shëndetësor të miratuar nga Ministri i përgjegjës për shëndetësinë.
- k. Raporton pranë DRSH/DSHP\ASHR-ve përkatëse, dhe monitorohet periodikisht prej tyre sipas listave të kontrollit që përfshihen në paketën bazë të shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor.
- l. Lidh kontratën për financimin e paketave shëndetësore të ofruara nga Q.SH., me DRFSDKSH.
- m. Përgjigjet për raportimin financiar sipas kërkesave të FSDKSH.
- n. Përfaqëson Q.SH. në marrëdhënie me DRSH/DSHP/ASHR dhe DRFSDKSH, institucione të tjera dhe me të tretët.
- o. Nënshkruan të gjitha aktet dhe kontratat që angazhojnë Q.SH. ndaj subjekteve apo personave të tjerë juridikë në përputhje me rregullat në fuqi.
- p. Propozon në Ministrinë e Shëndetësisë si dhe njofton DSHP/DRSH/ASHR për ndryshimet në strukturën e Q.SH.
- q. Merr në dorëzim rregullisht inventarin aktual të mjeteve në përdorim të Q.SH.

Neni 5

Punësimi në Q.SH.

1. Punësimi i profesionistëve të shëndetësisë mjek dhe infermier në Q.SH. bëhet nga Ministri përgjegjës për shëndetësisë.
2. Drejtori i Q.SH i paraqet Ministrisë së Shëndetësisë vendet e lira për mjek dhe infermier dhe njofton pranë DRSH\DSHP\ ASHR.
3. Ministria e Shëndetësisë bën publike dhe organizon konkurrimin për vendet e lira të shpallura për mjek dhe infermier në nivele rajonale. Kriteret e përzgjedhjes bazohen në Urdhërin e Ministrit përgjegjës për shëndetësinë, "Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik".
4. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, ngre komisionin ad- hoc për organizimin e konkursit të hapur për të gjithë kërkesat e bëra nga Q.SH. në nivel rajonal. Komisioni ad-hoc administron dosjet e kandidatëve që konkurojnë për punësim. Në përfundim të konkursit, në procesverbal përshkruhet e gjithë procedura e ndjekur duke përfshirë argumentimin për shpalljen e fituesit si dhe pikëzimi për secilin konkurent.
5. Vendimi i komisionit me dokumentacionin përkatës pas përfundimit të konkurimit me emrin e fituesit i dërgohet Drejtorit të Q.SH. i cili autorizohet për lidhjen e kontratës individuale të punës. Ky vendim i komisionit ad-hoc i njoftohet edhe DRSH/DSHP/ ASHR përkatëse si dhe DRFSDKSH.
6. Në rastet kur në konkurs për personelin mjekësor paraqitet vetëm një kandidaturë, Ministria e Shëndetësisë, autorizon drejtorin e Q.SH. të lidhë kontratën e punës me kandidatin e vetëm të paraqitur.
7. Drejtori i Q.SH. në rastet e ndërprerjeve të menjëhershme të marrëdhënieve të punës ose largimit me leje afatgjatë të personelit mjekësor, kërkon miratim për lidhjen e kontratës së përkohshme të punës pranë Ministrisë së Shëndetësisë.
8. Personeli mbështetës i Q.SH. emërohet nga drejtori i Q.SH. sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës dhe normave të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë.
9. Kontratat e punës për personelin e Q.SH. bazohen në dispozitat e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe në normat e punës të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë.
10. Dokumentacioni origjinal, i personelit të Q.SH., mbahet pranë zyrave të DRSH/ DSHP/ASHR dhe një kopje e tyre mbahet pranë Q.SH.

Neni 6

Financimi i Q.SH.

1. Q.SH. financohet nga:
 - a. Ministria e Shëndetësisë;
 - b. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
 - c. Burime të tjera sipas legjislacionit në fuqi.
2. Përdorimi i tyre bëhet nga vetë Q.SH., si pjesë e kostos së shërbimit, sipas një udhëzimi të miratuar nga Këshilli Administrativ i Fondit.

Neni 7

Masat disiplinore dhe zgjidhja e kontratës

1. Personelit të Q.SH. i jepen masa disiplinore për mosrespektimin e detyrave, thyerjen e disiplinës në punë, rregullave të etikës, kodit deontologjik dhe në rastet e mosrespektimit të kontratës së punës të nënshkruar.
2. Llojet e masave disiplinore janë të parashikuara në Kontratën Kolektive të Punës dhe në kontratën që Q.SH. ka me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Masat disiplinore jepen nga drejtori i Q.SH. sipas një procedure administrative, e cila garanton të drejtën për t'u informuar, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar. Ankimi kundër masave të drejtorit të Q.SH. për personelin mjekësor bëhet pranë Ministrisë së Shëndetësisë sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
3. Masat e përcaktuara në aktet e mësipërme mund të shlyhen në qoftë se brenda një viti nga dita e dhënies së tyre, nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore që shlyhen hiqen nga dosja vetjake.

Neni 8

Vula

Vula e Q.SH. miratohet nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë, dokumentet e Q.SH. ruhen dhe administrohen sipas rregulloreve të nxjerra nga Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".

Neni 9

Dispozitë tranzitore

Strukturat e Q.SH. të rishikohen dhe më pas të miratohen në bashkëpunim me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij statuti.

MINISTRI

ILIR BEQAJ

